



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES

Nr. _____ prot.,

Datë _____._____.2025

V E N D I M

Nr. 23 datë 03. 11. 2025

PËR

**“MIRATIMIN E DOKUMENTIT: RREGULLORE “PËR TË DHËNAT STATISTIKORE
DHE FINANCIARE PERIODIKE TË SIPËRMARRËSVE TË RRJETEVE DHE/OSE
SHËRBIMEVE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	Gentian Sala	Kryetar
Znj.	Edlira Dvorani	Anëtar
Z.	Lorenc Bako	Anëtar
Z.	Bleron Dokle	Anëtar
Z.	Armer Juka	Anëtar

dhe sekretare znj.Xhilda Hoxha, në mbledhjen e datës 03. 11. 2025, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, dhe Rregulloren e Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare” miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, si dhe ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Miratimin e dokumentit – “Rregullore “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”

BAZA LIGJORE:

1. Neni 12 (pika 2, germa gj), neni 41 të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”;
2. Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” (Ligji nr. 44/2015);

3. Rregullore për Procedurat e Këshillimit Publik, miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP nr.21, datë 7.12.2021.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë si më poshtë:

1. Dokumenti: “Projektregullore “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike” Dokumenti përfundimtar”;
2. Projektvendimi i formatuar dhe arsyetuar;
3. Relacioni shoqërues i projektvendimit.
4. Komentet e palëve të interesuara të paraqitura gjatë Këshillimit Publik dhe qëndrimi përkatës;

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. Këshilli Drejtues i AKEP me Vendim Nr.14, datë 25.09.2025, ka miratuar për Këshillim Publik dokumentin “Projektregullore “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike””.
2. Procesi i këshillimit publik për dokumentin “Projektregullore për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”, së bashku me formularët përkatës të përfshirë në Aneksin 1, u zhvillua për një periudhë 30-ditore. Dokumenti u publikua në faqen zyrtare të AKEP më datë 26.09.2025, ndërsa periudha e konsultimit publik përfundoi më datë 27.10.2025. Në përfundim të procesit të këshillimit publik, nga palët e interesuara u depozituan në AKEP, komente vetëm nga sipërmarrësi “One Albania” sh.a., përcjellë me shkresën nr. 2145, datë 27.10.2025 (*Prot AKEP 1534 datë 29.10.2025*).
3. AKEP, pas marrjes dhe vlerësimit të komenteve të palëve për dokumentin e nxjerrë në këshillim publik, ka përgatitur dokumentin “Projektregullore për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike” – Dokumenti përfundimtar”.
4. Dokumenti “Projektregullore “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike””, u miratua nga AKEP duke u bazuar në përcaktimet e ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”. AKEP, çmon si të rëndësishme hartimin e rregullores “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”- dokumenti përfundimtar, duke e përshtatur me kërkesat dhe parimet e ligjit nr. 54/2024 dhe harmonizim i dispozitave me kuadrin e ri ligjor, për të siguruar përputhshmëri dhe efektivitet rregullator.
5. AKEP, vlerëson se projektakti administrativ rregullor “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”, e cila është përgatitur në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës, si

dhe praktikave më të mira ndërkombëtare, siguron harmonizimin e plotë me detyrimet për mbledhjen, përpunimin dhe publikimin e statistikave;

6. Dokumenti përfundimtar i AKEP, “Rregullore për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”, përmban:

- rregullat dhe procedurat e detajuara për raportimin periodik të të dhënave nga sipërmarrësit e pajisur me autorizim të përgjithshëm, përfshirë formatet e dorëzimit on-line, afatet përkatëse të depozitimit, si dhe mënyrat e verifikimit, korrigjimit dhe ruajtjes së informacionit;
- dispozitat mbi përdorimin e të dhënave nga AKEP për monitorimin dhe analizën e tregut, publikimin e raporteve periodike dhe zbatimin e parimeve të konfidencialitetit;
- referencat për sanksionet në rast mosdorëzimi të të dhënave sipas afateve;
- Aneks 1, që përmban formularët statistikor dhe financiarë në format Excel, të cilët operatorët duhet t’i plotësojnë dhe depozitojnë sipas kërkesave të rregullores.
- nga pikëpamja e ligjshmërisë është konform me përcaktimet ligjore të nenit 12 (pika 2, germa gj), nenit 41 të ligjit nr. 54/2024 të ligjit nr. 54/2024.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 14, pikës 1 të nenit 15 dhe neneve 44 dhe 45 të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S I:

1. Të miratojë dokumentin: “Rregullore “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike””, sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Ky Vendim dhe Dokumenti: “Rregullore “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike””, të publikohen në faqen e internetit të AKEP, www.akep.al.
3. Rregullore nr.12, datë 07.04.2010 “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”, e ndryshuar, shfuqizohet.
4. Ky vendim hyj në fuqi në datën e miratimit të tij.

Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Gentian Sala	Edlira Dvorani	Lorenc Bako	Bleron Dokle	Armer Juka